Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

5.7 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 42 të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore.”

Seksioni 6. Nënshkrimi i kontratës

6.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti përgjegjës njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 21. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

## 6.2 Sigurimi i kontratës

6.2.1 Autoriteti përgjegjës kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 15 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 25 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

6.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- i. garanci bankare
- ii. garanci sigurimi

## 6.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti përgjegjës dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar

Shënim: Autoritetet përgjegjës e nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 6.

## III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

- Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.  
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë.  
Shtojca 3: Formulari i Ofertës Ekonomike.  
Shtojca 4: Deklaratë për paraqitje ofertë të pavarur.  
Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës.  
Shtojca 6: Formulari i Informacionit Konfidencial.  
Shtojca 7: Deklaratë mbi konfliktin e interesit.  
Shtojca 8: Deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik.  
Shtojca 9: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër.  
Shtojca 10: Deklaratë mbi përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme për Kualifikim.  
Shtojca 11: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.  
Shtojca 12: Formular vlerësimi.  
Shtojca 13: Deklarata e disponueshmërisë së makinerive.  
Shtojca 14: Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industrial  
Shtojca 15: Formulari Kriteret e përgjithshme/të veçanta të Kualifikimit/pjesëmarrjes.  
Shtojca 16: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike.  
Shtojca 17: Preventivat e punimeve.  
Shtojca 18: Grafiku i zbatimit të punimeve.  
Shtojca 19: Formular i Njoftimit të skualifikimit.  
Shtojca 20: Formulari i Njoftimit të Fituesit.  
Shtojca 21: Formulari i Njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër.  
Shtojca 22: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.  
Shtojca 23: Kushtet e Veçanta të Kontratës.  
Shtojca 24: Formulari i Sigurimit të Kontratës.  
Shtojca 25: Formulari i publikimit të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar.  
Shtojca 26: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim.  
Shtojca 27: Formulari i Anulimit të Procedurës.  
Shtojca 28: Formulari i Ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik.  
Shtojca 29: Draft Marrëveshja Kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.  
Shtojca 30: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Shtojca 1

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË

\_\_\_\_\_  
(Emri i operatorit ekonomik )

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje në këtë procedurë:

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Përgjegjës)

fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Punëve të mëposhtme:

.....  
.....  
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratë dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionit të Tenderit (DT)).

Vendi i kryerjes së punës

(jepni një përshkrim te shkurtër)

Afati i punimeve \_\_\_\_\_

Oferta duhet të paraqitet

.....  
[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....  
[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese \_\_\_\_\_

Forma e komunikimit:

Me shkrim

elektronike (email, fax, etj)

Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

Shtojca 4

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

DEKLARATËPër paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: \_\_\_\_\_; nga Autoriteti Përgjegjës: \_\_\_\_\_; me objekt: \_\_\_\_\_; me fond limit: \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: \_\_\_\_\_që:

(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Përgjegjës;
  - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

---

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

---

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 5

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]



Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.references ne faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit përgjegjës] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti përgjegjës e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.
- Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

#### LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial


**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

**DEKLARATË****Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga

pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
\_\_\_\_\_

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

## DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti përgjegjës), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër ]

PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës

01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

#### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është

një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 te Aktit normative nr.9/2019.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019<sup>2</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Shtojca 11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË  
MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë

konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

**FORMULAR VLERËSIMI**

( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti Përgjegjës /Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
<b>VËRTETOJ SE:</b>	
Autoriteti Përgjegjës /Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPDET/ Nënkontraktoret NIPDET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Përgjegjës	

Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_



Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: \_\_\_\_\_

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin përgjegjës të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 14

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet te deklarojnë se nuk kane pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndertimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 15

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës ]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet: Marrëveshja e bashkëpunimit<sup>4</sup> ndërmjet operatorëve ekonomikë.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

*c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;*

*ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;*

*e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*

*f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*

*g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;*

*gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës perkatëse. (plotësohet nga te gjithë OE ne rast bashkimi operatoresh.

2.1.2 Sipas kriterëve te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve (2018-2019 dhe 2020), ku mesatarja e te tre viteve, duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e fondit limit. Për të vërtetuar plotësimin

<sup>4</sup> Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” neni 14

e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë tre viteve 2017, 2018 dhe 2019. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga autoriteti përkatës dhe të shoqëruar me raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara te taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2020, sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me Ligjin "Për Prokurimin Publik".

### 2.3 Për kapacitetin teknik:

#### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme e realizuar në një kontratë të vetme në një vlerë jo më e vogël se 50 % e fondit limit, të realizuar gjatë tri viteve të fundit ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

*Ose*

b) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogël se dyfishi i fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

#### Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Faturat tatimore;

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë siper marrje;
2. Leje Ndertimi;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt-Kolaudimi;
5. Fatura tatimore;

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e

*dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

#### PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP- 1 A Punime gërmimi në tokë  
 NP- 3 C Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.  
 NP-12 C Punime të inxhinierisë mjedisore

#### PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS- 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.  
 NS- 3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)  
 NS- 4 C Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.  
 NS- 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese  
 NS- 9 A Punime strukturore speciale  
 NS- 12 B Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit  
 NS- 14 B Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV  
 NS- 18 A Punime topogjeodezike

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetedhjetë) personave të siguruar për periudhen Tetor 2020 - Mars 2021. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;  
 b) Listë-pagesat e punonjësve të konfirmuar nga Administrata Tatimore për muajt e kërkuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojë në Licensën e kompanisë:

#### 1. Staf i teknik

- |   |         |
|---|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi                       | 1 (nje) |
| b. Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist) | 1 (nje) |
| c. Inxhinier Elektrik                       | 1 (nje) |
| d. Inxhinier Elektronik                     | 1 (nje) |
| e. Inxhinier Hidroteknik                    | 1 (nje) |
| f. Inxhinier Mjedis                         | 1 (nje) |

-Për stafin e mesipër Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare, Libreze pune. si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht gjashtë muajt e fundit Tetor 2020 - Mars 2021.

2.3.5 Staf i inxhinierik drejtues ose mbështetës duhet të jetë i certifikuar si me poshtë:

- 1- (nje) Inxhinier i certifikuar “Auditues Energjie”,  
 1- (nje) Inxhinier i certifikuar si “Kordinator Sigurie në fazën e zbatimit”,  
 - 1- (një) Inxhinier që duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimit (Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

- 1 (nje) inxhinier i cili të disponojë certifikatë për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.

Per stafin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet: Certifikatat perkatese te dhëna nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesat e kompanise se paku gjashte muajt e fundit Tetor 2020 - Mars 2021.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë staf mbeshtetes të punësuar punonjesit e meposhtem:

Punonjesit:

- Teknik Ndertimi 1 (nje), i paisur me *Diplome te shkolles se mesme.*
- Teknik ndertimi 1 (nje), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*
- Teknik hidraulik 1 (nje), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*
- Teknik mekanik 1 (nje), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*
- Kapertier 2 (dy), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*
- Shofer Kamioni 3 (tre), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi dhe patente*
- Eskavatorist 1 (nje), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*
- Fadromist 1 (nje), i paisur me *Deshmi aftesise profesionale/certifikata trajnimi*

*Për punonjësit e mësipërm perveq dokumentacionit te kerkuar mesiper duhet të paraqiten dhe kontrata e punës e vlefshme, Librezat e punes, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit Tetor 2020 - Mars 2021.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, diplomën përkatëse. (Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	1
2	Kamion me kapacitet mbajtes 10-20 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	2
3	Kamion me kapacitet mbajtes 1-2 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	1
4	Kamion me vinç	Ne pronesi ose me qera	cope	1
5	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	cope	1
6	Fadrome	Ne pronesi ose me qera	cope	1
7	Autobot uji	Ne pronesi ose me qera	cope	1
8	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	cope	1
9	Autovinc	Ne pronesi ose me qera	cope	1
10	Rrul gome-hekur	Ne pronesi ose me qera	cope	1
11	Rrul hekur-hekur	Ne pronesi ose me qera	cope	1
12	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	cope	5

13	Gjenerator	Ne pronesi ose me qera	cope	1
14	Skeleri	Ne pronesi ose me qera	M2	10,000

- Kokore +Jeleke fosforoshente, minimumi 80 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 30 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronese; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, foto;
- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuiivalentin e saj
- OHSAS 18001:2015 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuiivalentin e saj
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” ose ekuiivalentin e saj.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

2.3.10/1 Per Bojrat

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.10/2 Per Pllakat



- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.10/3 Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino) :

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.10/4 Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi per materialet inerte. Kontrata te shoqerohet me leje mjedisore dhe dokumentacionin perkates te nyjes se inerteve.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 13, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 13, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor. *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojcës 13, ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor (KVO). *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*

2.3.15 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.

2.3.16 Vetedeklarim nga Operatori Ekonomik ku te deklarohet posta zyrtare elektronike subjektit, e cila do te perdoret nga AK si forme komunikimi zyrtar ne fazen e dyte te procedures se prokurimit.

2.3.17 Çdo ofertues do te paraqese PLANIN E SIGURISE NE KANTIER Per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003.sipas kerkesa, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

*Ne rastet e pjesemarrjes se operatoreve ekonomik te huaj, detyrimisht te gjitha dokumentat te jene te apostiluar sipas legjislacionit ne fuqi.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 16

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)*

